



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 17/2023¹
PËR THEMELIMIN, NDRYSHIMIN APO SHUARJEN E
INSTITUCIONEVE KORREKTUESE

¹Udhëzim Administrativ MD - Nr. 17/2023 për themelimin, ndryshimin apo shuarjen e institucioneve korrektuese, i nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë më datë 22.12.2023

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të Nenit 23 të Ligjit nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës (GZ Nr. 20, 08.08.2022), duke u bazuar nënin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L- 117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr.09/2011;

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 17/2023 PËR THEMELIMIN, NDRYSHIMIN APO SHUARJEN E INSTITUCIONEVE KORREKTUESE

KAPITULLI I DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është themelimi, ndryshimi dhe shuarja e Institucioneve Korrektuese si dhe përcaktimi i llojit, tipi dhe selisë së institucionit korrektues.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky Udhëzim Administrativ është i zbatueshëm për të gjitha Institucionet Korrektuese të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

KAPITULLI II INSTITUCIONET KORREKTUESE

Neni 4 Llojet e institucioneve korrektuese

1. Shërbimi Korrektues me qëllim të ekzekutimit të sanksioneve penale si: dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm, dënimin me burgim për të mitur, masën edukuese korrektuese për të mitur si dhe masën e paraburgimit, përbëhet nga këto Institucione Korrektuese:

1.1. Qendrat Korrektuese;

1.2. Qendrat e Paraburgimit;

1.3. Burgu i Sigurisë së Lartë.

2. Në kuadër të një Institucioni Korrektues mund të ekzistojnë njësi të tipit të mbyllur, gjysmë të hapur dhe të hapur, varësisht nga nevojat e institucionit.

Neni 5 **Institucionet korrektuese të tipit të mbyllur**

1. Institucione korrektuese të tipit të mbyllur janë:

1.1. Qendra Korrektuese Dubravë, Dubravë- Istog;

1.2. Qendra e Paraburgimit Prishtinë, Hajvali - Prishtinë;

1.3. Qendra e Paraburgimit Prizren, Prizren;

1.4. Qendra e Paraburgimit Gjilan në Pasjak, Novobërd;

1.5. Qendra e Paraburgimit Pejë, Pejë;

1.6. Qendra e Paraburgimit Mitrovicë, Mitrovicë;

1.7. Burgu i Sigurisë së Lartë në Gërdoc, Podujevë.

2. Institucionet korrektuese të tipit të mbyllur kanë elemente maksimale të sigurisë fizike dhe materiale siç janë: muret e larta rrethuese apo rrethoja me tela gjemborë, staf të armatosur, pajisjet teknike dhe masat tjera të sigurisë.

3. Të burgosurit e vendosur në këto institucione të drejtat dhe beneficinet i realizojnë sipas tretmanëve përkatëse.

Neni 6 **Institucionet korrektuese të tipit gjysmë të hapur**

1. Institucionet korrektuese të tipit gjysmë të hapura janë:

1.1. Qendra Korrektuese për të Mitur, Hallaq i Vogël, Lipjan;

1.2. Qendra Korrektuese për Femra në Hallaq i Vogël, Lipjan.

2. Institucionet korrektuese të tipit gjysmë të hapur kanë elemente të mesme të sigurisë fizike dhe materiale.

3. Të burgosurit e vendosur në këto institucione të drejtat dhe beneficinet i realizojnë sipas tretmanëve përkatëse.

Neni 7
Institucionet korrektuese të tipit të hapur

1. Institucionet Korrektuese të tipit të hapur janë:
 - 1.1. Qendra Edukuese Korrektuese për të Mitur në Hallaq i Vogël, Lipjan;
 - 1.2. Qendra Korrektuese Smrekonicë, Vushtrri.
2. Institucionet korrektuese të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni janë institucione të tipit të hapur të cilat kanë elemente të ulët sigurisë fizike dhe materiale.
3. Personat e dënuar të vendosura në këto institucione të drejtat dhe beneficionet i realizojnë sipas tretmanëve përkatëse.

KAPITULLI III
NJËSITË NË INSTITUCIONET KORREKTUESE

Neni 8
Tipet e njësive brenda Institucioneve Korrektuese

1. Në Institucionet Korrektuese përcaktohen njësi të tipit të mbyllur, gjysmë të hapura dhe të hapura. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues me qëllim të aplikimit të tretmanëve për të burgosur, përcakton me vendim tipin e njësisë në pavijon, krahun e pavijonit apo pjesën e krahut të pavijonit brenda institucionit korrektues.
2. Në kuadër të institucionit korrektues për femra përcaktohet objekti i posaçëm për trajtimin e të burgosurave shtatzëna dhe nënave me fëmije deri në moshën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
 - 2.1. Femrat e burgosura të vendosura në objektin e posaçëm, të drejtat dhe beneficionet i realizojnë sipas tretmanit përkatës.
3. Brenda institucioneve korrektuese ekzistojnë stacionar për trajtimin dhe ekzaminimin shëndetësor për të burgosur.

Neni 9
Themelimi, ndryshimi dhe shuarja e institucioneve korrektuese

1. Institucioni Korrektues mund të ndryshohet apo shuhet nëse paraqiten rrethana apo vlerësohet nga organet kompetente për ndryshimin apo shuarjen e tij.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës i propozon Ministrin të Drejtësisë themelimin, ndryshimin apo shuarjen e institucionit korrektues.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

22/12/2023